



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 18/1 Prot.

Tiranë, më 11.01.2021

V E N D I M
Nr.2, dt. 11.01.2021

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 188, DATË 15.12.2020, TË
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, përfshirë institucionin Ministria e Drejtësisë.

Në kuadër të procesit të verifikimit, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Ministria e Drejtësisë, e cila ka raportuar nëpërmjet shkresës nr.3193/1 prot., datë 05.06.2020, se punonjësja ***** (datëlindja 04.11.1959), në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar”, e ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 04.11.2020.

Mbi këtë bazë, në zbatim të dispozitës ligjore të parashikuar nga germa c), e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri, me Vendimin Paralajmërues nr. 188, datë 15.12.2020, ka vendosur:

1. “Të kërkoj nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të ligjit, si dhe pasqyrimin e akteve në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) për punonjësen e mëposhtme:
 - *****, në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar”.
2. Pozicioni respektiv i punës, të raportohet pranë Departamentit të Administratës Publike si pozicion i lirë dhe DAP të vijojë procesin për plotësimin e tij sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.
3. Kryerja e veprimeve të mësipërme, duhet të bëhet brenda 7 ditëve nga marrja dijoni për këtë vendim...”

Në vijim të zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 188, datë 15.12.2020, të Komisionerit, institucioni Ministria e Drejtësisë, përmes shkresës së dërguar me nr. 7787/1 prot., datë 06.01.2021, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 18 prot., datë 08.01.2021, ka informuar se Ministria e Drejtësisë mori masat administrative duke nxjerrë Vendimin nr. 1, datë 06.01.2021 “Për ndërprerje të marrëdhënieve financiare, për znj. *****”. Njëkohësisht, në përmbajtjen e kësaj shkrese është kërkuar shtyrja e afatit të ndërprerjes së marrëdhënieve financiare për punonjësen ***** deri në plotësimin e pozicionit të punës nga DAP, nëpërmjet procedurave të konkurrimit për arsyet e mëposhtme:

- për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid 19, ka qenë e pamundur të finalizohen procedurat e rekrutimit për pozicionet e nivelit të mesëm drejtues;
- volumi i punës për mbylljen e vitit buxhetor 2020 dhe për çeljen e vitit buxhetor 2021 është shumë i madh dhe *****, si nëpunëse zbatuese e aparatit të Ministrisë së Drejtësisë, luan një rol kyç në mirëfunksionimin dhe realizimin e këtij procesi delikat, i cili kërkon një përvojë të caktuar, saktësi dhe korrektësi;
- largimi i ***** do të lërë shumë procese të rëndësishme financiare pezull, të cilat janë me afate të ngutshme, por gjithashtu do të ndikojnë në keqmenaxhimin e buxhetit të aparatit të Ministrisë së Drejtësisë.

Në analizë të sa më lart kur, ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënies së punës për nëpunësen *****, do të sillte pengesa në realizimin e detyrave të mësipërme, si dhe do të krijonte pengesa në ecurinë normale të punës së institucionit, vlerësoj se, kërkesa për shtyrjen e afatit për ekzekutimin e Vendimit Paralajmërues nr. 188, datë 15.12.2020, “Mbi paralajmërimin e institucionit Ministria e Drejtësisë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”, të Komisionerit, nga ana e institucionit Ministria e Drejtësisë është e drejtë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, kreu IV “Rishikimi”, nenet 144, 145 dhe 146, si dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të ndryshoj pikën 3, të Vendimit nr. 188, datë 15.12.2020, me përmbajtje si më poshtë:

“3. Të vijojë marrëdhënia në shërbimin civil për punonjësen *****, me detyrë “Drejtor në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar”, në Ministrinë e Drejtësisë, deri në përfundimin e procedurës së rekrutimit për plotësimin e këtij pozicioni pune.”

2. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Ministria e Drejtësisë, Departamenti i Administratës Publike dhe Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha